



Morrat – hiqini tej!



Morrat janë bezdisëse dhe mund t'i zini më shpejt se sa i pastroni. Për ta pasur sa më të shkurtër e të rrallë të jetë e mundur praninë e morrave brenda familjes, po ju japim këtu pak informacion e këshilla.



Këshilla e informacion

Kontrollojeni fëmijën nëse mësoni se kanë rënë morrat në mjediset përreth.

Nëse fëmijën e kanë zënë morrat, informoni personat që kanë pasur kontakt të afërt me të.

Lidhini bashkë flokët e gjatë.

Jo të gjithë fëmijët kruhen nëse zënë morra.

Si t'i gjeni morrat?

Morrat janë të vështirë për t'u dalluar me sy të lirë. Kur sapo dalin nga vezët ata janë vetëm 1 deri 2 mm të gjatë - morrat e të rriturve janë rreth 3 mm të gjatë. Morrat hasen vetëm në flokë dhe shpesh në tëmtha, pas veshëve dhe në qafë. Në flokët e thatë morrat janë shumë të lëvizshëm dhe të vështirë për t'u gjetur. Ndaj këshillohet t'i lagni flokët kur kërkoni për morra, si dhe të vendosni me bollëk balsam/krem qetësues në flokë. Për t'i drejtuar flokët duhet t'i krihni mirë me krehër ose furçë. Dhe më pas flokët i krihni fije për fije nga vija e ballit deri në fund të flokut me krehrin kundër morrave (gjetet në farmaci). Pas krehjes së plotë, fshijeni krehrin kundër morrave në një letër të bardhë (p.sh. pecetë letre kuzhine) për të parë morrat dhe vezët e tyre.

Çfarë të bëni në rast morrash të gjallë?

Informoni menjëherë shkollën, kopshtin, çerdhen dhe prindërit e fëmijëve me të cilët fëmijës suaj i pëlqen të mbajë kokën pranë, nëse konstatooni se fëmija ka zënë morra. Kjo mund të parandalojë përhapjen e mëtejshme.

Merrni **solucionin kundër morrave** dhe përdoreni sipas udhëzimeve. Zgjedhjen e tij mund ta diskutoni me Shërbimin e Shëndetit për të Rinjtë dhe Fëmijët, pediatri ose farmacistin. Në studimet klinike janë konstatuar produktet e mëposhtme (fizikisht aktive) si veçanërisht efikase dhe pa efekte anësore: Hedrin (Xpress), Paranix (Spray). Flokët e gjatë e të dendur kanë nevojë për sasi më të mëdha shampoje kundër morrave: Përdorimi i një sasive të vogël shampoje është dhe një nga arsytet e shpeshta përse trajtimi rezulton pa sukses.

Zgjidhjet e zakonshme kundër morrave veprojnë kundër morrave të gjallë, por nuk godasin edhe morrat që nuk kanë dalë ende nga vezët. Prandaj rekomandohen dy trajtime në intervale prej 7-9 ditësh për të vrarë edhe morrat e sapodalë nga vezët. Gjatë kësaj kohe nuk ka pse i frikësoheni infektimit të të tjerëve, pasi morrat e sapodalë nga vezët nuk kanë ende aftësi riprodhimi.

Nëse flokët i krihni dy herë në javë për një muaj me krehrin kundër morrave, keni mundësi të kontrolloni suksesin e trajtimit dhe të parandaloni riinfektimin.



Këshilla e informacion

Trajtojeni fëmijën me shampo kundër morrave nëse dalloni morra të gjallë.

Nëse gjeni morra të gjallë te fëmija juaj, kontrolloni në vijim të gjithë anëtarët e familjes.

Mos u lodhni më kot të pastroni çarçafët e mbulesat, rrobat, lodrat etj. pasi morrat nuk kalojnë dot nëpër sende të tilla!

Vëriini krehtrat dhe mjetet e kujdesit të flokëve për t'i pastruar në një solucion të nxehtë (60°C) me sapun për 10 minuta.

Kam gjetur vetëm thërrija ose vezë morrash: çfarë të bëj?


Bëni kujdes dhe krihini flokët dy herë në javë për 2 javë me një krehër kundër morrave, siç përshkruhet nga përpara. Nëse gjeni morra të gjallë, trajtojini menjëherë. Nëse nuk gjeni morra të gjallë gjatë kontrollit, nuk ka nevojë të bëni gjë tjetër. Thërrijat (lëvozhga vezësh bosh) janë mandej thjesht një „problem“ kozmetik: Ndryshe nga zbokthi, thërrijat ngjiten pas flokut dhe nuk hiqen aq lehtë. Nëse fëmijën e keni pa morra, duhet ta kontrolloni gjithsesi rregullisht për morra gjatë javëve në vazhdim.

Kemi gjetur sërish morra, ku jam duke gabuar?

Fëmija mund t'i ketë zënë sërish diku ose mund të mos i keni hequr të gjitha morrat gjatë trajtimit të fundit. Nëse, pavarësisht trajtimit, mendoni se nuk po e vini dot nën kontroll problemin, mund të na kontaktoni për një konsultë falas.

Morrat – ia vlen të dini!

Morrat mbijetojnë vetëm në kokën e njeriut dhe ushqehen me gjakun e tij. Femrat e morrit kanë jetëgjatësi prej 4 deri 5 javë dhe, nga dita e 9-të, lëshojnë vezë me madhësinë e një kokrrize rëre, të cilat i ngjiten flokut pranë lëkurës së kokës me një substancë si mastiç. Morrat e rinj dalin nga vezët pas maksimumi 10 ditëve. Morrat nuk mund të zhduken dhe njeriu duhet të mësohet të jetojë me to. Zënia e morrave ndodh rëndom në rajone me dendësi të lartë të popullsisë. Ngjitja tek të tjerët ndodh përmes kontaktit të drejtpërdrejtë të flokëve, p.sh. kur fëmijët i vënë kokat bashkë gjatë lojërave. Zënia e morrave nuk ka të bëjë aspak me higjienën personale, por është shenjë e kontaktit të ngushtë shoqëror. Morrat nuk mund të kërcëjnë, notojnë apo fluturojnë. Ata gjithashtu nuk barten përmes sendeve apo kafshëve.



Informacion i mëtejshëm

► Këtë mund të gjeni në faqen www.lausinfo.ch